

L I G J
Nr.8502, datë 30.6.1999

PËR KRIJIMIN E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i Qendrës

(ndryshuar fjalia e fundit e parag te pare)
Ndryshuar paragrafi I trete)

Krijohet Qendra e Publikimeve Zyrtare në Republikën e Shqipërisë, e cila më poshtë do të cilësohet "Qendra". **Qendra e Publikimeve Zyrtare është institucion qendror, në varësi të Ministrit të Drejtësisë."**

Përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë, Qendra, nëpërmjet botimit të Fletores Zyrtare, bën të mundur që të marrin fuqi juridike ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të institucioneve të tjera qendrore.

Qendra, me anë të botimeve, publikimeve dhe veprimtarive të tjera synon njohjen nga organet shtetërore dhe institucionet e tjera të administratës publike, nga personat fizikë dhe juridikë, të ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara ose në të cilat aderohet, akteve normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore, të akteve të tjera të rëndësishme të nxjerra nga organet dhe institucionet shtetërore, si dhe të teksteve e të literaturës juridike, në shërbim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të tyre, të forcimit të rendit juridik dhe kushtetues."

Neni 2

(ndryshuar me ligjin nr.9091/2003)

Qendra boton:

a) marrëveshje ndërkombëtare, të ratifikuara ose në të cilat aderohet, ligje, dekrete të Presidentit të Republikës, akte normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore, vendime të Gjykatës Kushtetuese së bashku me mendimin e pakicës, vendime të Gjykatës së Lartë për njësimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore, si dhe çdo akt e dokument tjetër të organeve shtetërore, botimi i të cilave është i detyruar me ligj;

b) akte të tjera nënligjore, që nuk përfshihen në shkronjën "a" të këtij neni;

c) raporte zyrtare ose dokumente të tjera të organeve dhe institucioneve shtetërore, përmbajtja e të cilave paraqet interes shtetëror dhe publik;

ç) revistën periodike "Drejtësia";

d) tekste juridike universitare, periodike, të organeve dhe institucioneve qendrore në fushën e së drejtës dhe të literaturës juridike;

dh) indekse të përgjithshme dhe indekse për fusha të veçanta në ndihmë të subjekteve të

interesuara dhe të publikut.".

Neni 3

Me kërkesë të subjekteve të interesuara dhe kundrejt tarifave përkatëse, Qendra u lëshon këtyre subjekteve kopje të akteve të ndryshme ligjore e nënligjore, përfshirë edhe ndryshimet që kanë pësuar periodikisht këto akte.

Pranë Qendrës mund të njihet, drejtpërdrejt dhe pa shpërblim, përmbajtja e akteve dhe e dokumenteve që publikohen prej saj.

Neni 4

Qendra vetëm ose në bashkëpunim me organe dhe institucione shtetërore, organizata joqeveritare dhe individë, brenda dhe jashtë vendit, bën studime, konferenca shkencore dhe veprimtari të tjera në funksion të veprimtarisë së saj.

Neni 5

Mënyra e publikimit të akteve që përmbajnë të dhëna me karakter sekret

Qendra nuk publikon aktet normative nënligjore, të cilat janë cilësuar nga vetë akti me karakter sekret, sipas përcaktimeve të ligjit.

Me përjashtim të akteve, që ligjërisht janë të detyrueshme për publikim, Qendra mban përgjegjësi për të gjitha botimet lidhur me respektimin e rregullave për sekretin shtetëror.

Kur konstatohet mosrespektim i rregullave për sekretin shtetëror, fillimisht i bëhet i njohur organit dërgues dhe, në rast mospranimi, publikimi mund të bëhet vetëm me miratimin e Komisionit.

Për publikimin e dokumenteve të tjera, organet dhe institucionet përkatëse respektojnë vetë rregullat e ruajtjes së sekretit.

Neni 6

(ndryshuar me ligjin nr.9091/2003)

Botimi i akteve normative dhe i akteve të tjera nënligjore realizohet nga kjo qendër me botimin e Fletores Zyrtare, të përmbledhësve ose në forma të tjera, sipas fushave të legjislacionit.

Organi përgjegjës, sipas ligjit, është i detyruar të paraqesë për botim në Qendrën e Publikimeve Zyrtare aktet e parashikuara në shkronjën "a" të nenit 2 të këtij ligji brenda 3 ditëve nga miratimi i tyre dhe, në raste të veçanta, jo më vonë se 15 ditë.

Qendra duhet të realizojë botimin në Fletoren Zyrtare të akteve të parashikuara në shkronjën "a" të nenit 2 të këtij ligji brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tyre për botim nga organi përgjegjës sipas ligjit.

Botimi në Fletoren Zyrtare i akteve të parashikuara në shkronjën "b" të nenit 2 të këtij ligji realizohet, si rregull, brenda afateve të parashikuara në paragrafin e mësipërm.

Neni 7

(ndryshuar me ligjin nr.9091/2003)

Fletorja Zyrtare botohet rregullisht dy herë në muaj, në çdo 15 ditë, por jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja për botim e akteve të parashikuara në shkronjën "a" të nenit 2 të këtij ligji.

Në ndryshim nga rregulli i parashikuar në paragrafin e mësipërm, Fletorja Zyrtare botohet më shpesh ose përpara afatit të programuar, pasi të jetë marrë miratimi i Ministrisë së Drejtësisë ose i Këshillit të Qendrës, mbështetur në kërkesën e organit përgjegjës, që ka nxjerrë

aktin, ose në përmbajtjen e dispozitave të aktit të paraqitur për botim.

Fletorja Zyrtare përgatitet dhe kalon për botim me miratimin dhe nën përgjegjësinë e Drejtorit të Qendrës dhe, në mungesë të tij, nga i autorizuari prej tij.

Në Fletoren Zyrtare detyrimisht shënohet data e botimit të saj, në të kundërt publikimi nuk sjell pasojë juridike.

Këshilli i Qendrës miraton rastet dhe mënyrën e publikimit elektronik të përmbajtjes së Fletores Zyrtare. Këto publikime synojnë njohjen e të interesuarve me përmbajtjen e saj dhe nuk sjellin pasojë juridike.

Formati, kriteret teknike, procedurat e përgatitjes, autorizimi i botimit, tirazhi, mënyra e vënies në qarkullim dhe shpërndarja e Fletores Zyrtare, si dhe rregullat për përgatitjen, miratimin dhe publikimin e botimeve të tjera juridike të Qendrës, përcaktohen nga Ministri i Drejtësisë, pasi të ketë marrë mendimin e Këshillit të Qendrës.

Ribotimi dhe publikimi i plotë ose i pjesshëm i Fletores Zyrtare nga të tretë, me çfarëdo lloj mjeti, është i ndaluar.”.

Neni 8

(ndryshuar paragrafi I trete)

Një kopje e Fletores Zyrtare është e detyruar të tërhiqet nga institucionet shtetërore, qendrore e vendore, dhe sipas kërkesës dhe mundësisë së botimit edhe më shumë kopje.

Në muajin dhjetor të çdo viti institucionet shtetërore, organet qendrore e vendore, njoftojnë Qendrën për numrin e përgjithshëm të kopjeve të detyrueshme dhe numrin shtesë të tyre, si dhe destinacionin përkatës. Për organet vendore të dhënat jepen nga organi qendror i administratës shtetërore, i cili mbulon çështjen e pushtetit vendor.

Qendra, brenda 24 orëve nga data e botimit, dërgon Fletoren Zyrtare në organet shtetërore, institucionet dhe subjektet për të cilat është e detyruar të realizojë shpërndarjen me mjetet e veta, si dhe e dorëzon Fletoren Zyrtare në shërbimin postar, të kontraktuar për shpërndarjen e saj subjekteve të tjera, sipas listave të hartuara nga Qendra e Publikimeve Zyrtare.”.

Prefekturat realizojnë shpërndarjen e numrit të detyrueshëm të Fletores Zyrtare brenda 24 orëve nga ardhja.

Prefekturat venë në dispozicion të bibliotekave të qyteteve një kopje të Fletores Zyrtare, sipas kriterëve të shpërndarjes së detyrueshme.

Neni 9

Përmbledhësi i Përgjithshëm i Legjislacionit është korpusi i të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe i akteve të tjera që përmbahen në Fletoren Zyrtare, plotësuar periodikisht me botime vjetore të akteve të reja.

Përmbledhësit, sipas fushave të veçanta, botohen kryesisht nga Qendra ose me kërkesë të organeve shtetërore të interesuara. Në këto përmbledhëse mund të përfshihen edhe akte për të cilat nuk parashikohet ligjërisht botimi në Fletoren Zyrtare.

Neni 10

Botimet e parashikuara në pikën “c” të nenit 2, realizohen sipas planit vjetor bazuar në propozimet e organeve, të institucioneve përkatëse ose të autorëve.

Kur nuk pengohen botimet, sipas paragrafit të parë të këtij neni, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, mund të botohen edhe tituj të tjerë.

Kërkesat për botime jashtë planit vjetor për Kuvendin, për Presidentin e Republikës, për Avokatin e Popullit dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë, kur sigurohen prej tyre fondet e

nevojshme, janë të detyrueshme për Qendrën, edhe sikur të cenohet planifikimi, me përjashtim të Fletores Zyrtare.

Për oponentin e botimeve me karakter shkencor, Qendra mund të marrë edhe specialistë të fushave përkatëse, duke i shpërblyer sipas rregullave në fuqi.

Neni 11

Burimet e publikimeve

Të gjitha organet shtetërore dhe subjektet, aktet e të cilave publikohen nga Qendra, venë në dispozicion të saj kopje të vërtetuara të akteve të miratuara, menjëherë sapo bëhen të publikueshme sipas ligjit, por jo më vonë se 15 ditë.

Publikimet bazohen vetëm në kopjen e vërtetuar të aktit, dërguar nga organi që e ka nxjerrë.

Publikimi i akteve të shteteve të tjera ose të organizmave ndërkombëtarë bëhet mbi tekste të paraqitura nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Neni 12

Regjistri shtetëror qendror i akteve

Në Qendër krijohet regjistri shtetëror qendror i akteve, ku pasqyrohen të gjitha aktet e detyrueshme për botim ose që botohen nga Qendra me rubrika të veçanta për shfuqizimet, ndryshimet ose shtesat pas miratimit.

Përmbajtja e regjistrit shfrytëzohet drejtpërdrejt dhe nëpërmjet sistemit informatik.

Përmbajtja e regjistrit shtetëror qendror të akteve ka vlerë zyrtare, përveç rasteve kur informohet kryesisht ndryshe, nga organi që e ka kërkuar botimin ose me kërkesë të të interesuarve.

Regjistri dhe aktet e regjistruara, si pjesë e pandarë e tij, ruhen përgjithmonë.

Ndalohet botimi i akteve nga Qendra pa u pasqyruar në regjistrin shtetëror qendror.

Neni 13

Regjistrat e organeve dhe të institucioneve

Për aktet normative në kompetencë të tyre, organet dhe institucionet shtetërore mbajnë regjistër të veçantë dhe u japin informacion personave të interesuar, përveç rasteve kur ligjërisht nuk lejohet publikimi.

Neni 14

Përgjegjësia për dëmet nga publikimet e parregullta

Organi, që ka dërguar aktin ose dokumentin, mban vetë përgjegjësi për pasaktësi, parregullsi, gabime në përmbajtjen e aktit apo të dokumentit ose pengesë ligjore për publikim.

Qendra nuk mund të publikojë akte dhe dokumente për të cilat ka njoftime ose vërejtje të tilla, pa marrë përgjigje nga organi kompetent.

Qendra mban përgjegjësi kur publikimi nuk i përgjigjet tekstit të aktit ose dokumentit të dërguar nga organi përkatës, kur ka pranuar akte dhe dokumente në kundërshtim me këtë ligj, si dhe kur bën publikimin në kundërshtim me paragrafin e dytë të këtij neni.

Në çdo kohë, kryesisht ose me konstatim të të interesuarve, organi përkatës mund të kërkojë ndreqjen e gabimeve materiale dhe parregullsive, duke dërguar një kopje të re të aktit apo të dokumentit.

Kur ndreqja e gabimeve kërkohet pas publikimit, në të gjitha rastet bëhet njoftim në Fletoren Zyrtare.

Kur janë shkaktuar dëme nga publikimet e pasakta ose të parregullta, të interesuarit kanë të drejtë të kërkojnë përgjegjësinë ligjore dhe zhdëmtimin e drejtpërdrejtë të përgjegjësit, sipas këtij ligji.

Neni 15

Vlera zyrtare e botimeve të akteve

Botimet, kopjet e akteve ose konfirmimet e Qendrës kanë vlerë zyrtare.

Përmbajtja e tyre merret e mirëqenë, përveç rasteve kur, me kërkesë të të interesuarve ose kryesisht organi a subjekti që ka nxjerrë aktin vërteton përmbajtje tjetër.

Personaliteti juridik

Neni 16

Qendra është person juridik buxhetor, financimi i të cilit përfshihet në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

Mënyra e organizimit të veprimtarisë financiare përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë.

Botimet, konfirmimet dhe kopjet e akteve shpërndahen kundrejt shpërblimit, sipas kritereve të përcaktuara me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave.

Shpërndarja bëhet me anë të pajtimeve, në njësi të Qendrës ose me kontratim me të tretët.

Në urdhrin e përbashkët, të parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni, përcaktohen edhe organet, institucionet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilëve Qendra u dërgon botimet me mjetet e vet.

Neni 17

(ndryshuar me ligjin 9091/2003)

Të ardhurat nga shitja ose shërbimet derdhen:

90 për qind në Buxhetin e Shtetit;

b) 10 për qind në buxhetin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare, për përmirësimin e punës dhe për shpërblimin e punonjësve të saj.

Qendra, në përputhje me ligjin, ka të drejtë të përfitojë grante, sponsorizime dhe kontribute të tjera, nga subjekte vendase ose të huaja, të cilat përdoren për ushtrimin e veprimtarisë, sipas nenit 2 të këtij ligji."

Neni 18

Të drejtat e autorit

Aktet dhe vendimet e botuar nga Qendra mund të riprodhohen lirisht përveç rasteve kur ka ndalim me akt ligjor të veçantë.

Dokumentet mund të riprodhohen lirisht kur Qendra, në publikimin e tyre nuk është shprehur ndryshe, megjithatë ato mund të riprodhohen me leje të drejtëpërdrejtë të subjektit që ka autorizuar publikimin.

Qendra ushtron të drejtën e autorit për përmbledhëset e legjislacionit, indekset dhe çdo botim me karakter shkencor. Kur ndaj botimit kanë të drejta pronësie persona të tjerë fizikë dhe juridikë, të drejtat e autorit ushtrohen prej tyre.

Autorët e punimeve shkencore shpërblehen sipas rregullave në fuqi.

Neni 19
(ndryshuar me ligjin 9091/2003)

Organi më i lartë vendimmarrës i Qendrës së Publikimeve Zyrtare është Këshilli i saj.
Këshilli drejtohet nga përfaqësuesi i caktuar nga Ministri i Drejtësisë dhe ka në përbërje juristë, që përfaqësojnë Presidencën, Kuvendin, Këshillin e Ministrave, Gjykatën Kushtetuese, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Gjykatën e Lartë, Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës."

Neni 20

Anëtarët e Komisionit mund të ndryshohen në çdo kohë nga organi që përfaqësojnë.
Përfaqësuesi humbet menjëherë anëtarësinë kur nuk ka më cilësinë e përmendur në paragrafin e dytë të nenit 19 ose shkëput marrëdhëniet me organin përkatës.

Neni 21

Janë në kompetencë të Këshillit:

a) shqyrtimi dhe propozimi për miratim i drejtimeve të përgjithshme dhe i programit vjetor të veprimtarisë së Qendrës, si dhe ndjekja dhe kontrolli i zbatimit të tyre;"

b) autorizimi i botimeve të parashikuara në shkronjën d të nenit 2 dhe të paragrafit të tretë të nenit 5 dhe të paragrafit të dytë të nenit 7 të këtij ligji, si dhe të akteve normative të pushtetit vendor;

c) miratimi i botimit të përmbledhëseve të legjislacionit në fusha të veçanta;

ç) miratimi i veprimtarive të veçanta në shkallë kombëtare;

d) propozimi i masave disiplinore ndaj drejtuesve të Qendrës.

"dh) miratimi i përbërjes së Këshillit Botues të Revistës "Drejtësia"."

Neni 22

Paragrafi i parë dhe i pestë i nenit 22 shfuqizohen.

Komisioni mbledhet dhe kryesohet nga Ministri i Drejtësisë ose nga një person i autorizuar prej tij.

Mbledhja e Komisionit është e detyrueshme me kërkesën e çdo anëtari.

Për përgatitjen e materialeve dhe realizimin e veprimtarisë së tij, Komisioni cakton një sekretar, jurist me përvojë, i cili përfshihet në strukturën dhe organikën e Qendrës.

Komisioni vepron mbi bazën e rregullores së miratuar prej tij.

Vendimet dhe orientimet e Komisionit janë të detyrueshme për Qendrën, përveç kur vijnë në kundërshtim me këtë ligj ose nuk mbështeten në buxhetin e miratuar të saj.

Shpërblimi i anëtarëve të Komisionit caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Drejtimi administrativ

Neni 23

Drejtori është përfaqësues, bashkërendues me organet dhe institucionet shtetërore, organizues dhe përgjegjës për të gjithë veprimtarinë e Qendrës.

Në varësi të tij mund të caktohen zëvendësdirjtorët për anën juridike dhe atë tekniko-

ekonomike.

Drejtori merr pjesë në mbledhjet e Komisionit, pa të drejtë vote.

Drejtori paraqet raport për veprimtarinë e Qendrës përpara Komisionit në tremujorin e parë të vitit pasardhës dhe, me kërkesë të Komisionit, në çdo kohë për çështje ose drejtime të veçanta.

Neni 24 (ndryshuar me ligjin 9091)

Struktura, organika dhe pagat e punonjësve të Qendrës caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Drejtori i Qendrës gëzon statusin e nëpunësit civil.

Punonjësit e administratës së Qendrës së Publikimeve Zyrtare janë nëpunës civilë. Pranimi, transferimi, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë, u nënshtrohen kriterëve dhe procedurave të parashikuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të personelit administrativo-teknik rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Rregullorja e brendshme e Qendrës miratohet nga Ministri i Drejtësisë, pasi të ketë marrë mendimin e Këshillit të Qendrës dhe të Drejtorit të saj.

Ministri i Drejtësisë miraton dhe kontrollon zbatimin e drejtimeve të përgjithshme dhe programin vjetor të veprimtarisë së Qendrës, si dhe llogaritë financiare të saj, sipas dispozitave ligjore në fuqi.”.

Neni 25 **Përgjegjësia për shkeljen e ligjit**

Kur nuk ka vend për përgjegjësi penale dhe kur nuk parashikohet shprehimisht në aktet ligjore të fushës përkatëse si kundërvajtje administrative, për veprimet ose mosveprimet në kundërshtim me këtë ligj, punonjësit administrativë e teknikë mbajnë përgjegjësi disiplinore dhe detyrohen të zhdëmtojnë, sipas dispozitave në fuqi.

Dispozita kalimtare dhe të fundit Neni 26

Pranë Qendrës krijohet një komision i përkohshëm, për të evidentuar aktet dhe dokumentet e miratuara pas 1 janarit 1990, ligjërisht të detyrueshme për publikim, të cilat janë aktualisht në fuqi, por të papublikuara.

Qendra vë në dispozicion të Komisionit mjediset e mjetet e punës dhe përballon shpenzimet e nevojshme.

Komisioni është në varësi të Ministrit të Drejtësisë dhe përbëhet nga përfaqësuesi i tij, nga përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, i Kuvendit, i Këshillit të Ministrave, i Gjykatës Kushtetuese dhe i Gjykatës së Lartë.

Me kërkesë të Komisionit organet dhe institucionet përkatëse venë në dispozicion të tij kopje të vërtetuara të akteve dhe të dokumenteve të papublikuara, kur arrihet në përfundim se duhen publikuar.

Me vendim të Komisionit bëhet botimi i këtyre akteve në përmbledhëse të veçantë.

Për pjesëmarrjen në Komision organi përkatës shpërblen përfaqësuesit nga fondet e veta, në përputhje me rregullat në fuqi.

Neni 27

Zyra, e cila boton Fletoren Zyrtare, e mbyll veprimtarinë për botimin e saj me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe fondet financiare të pashpenzuara për këtë qëllim i kalojnë Qendrës.

Fondet dokumentare që janë në administrim të saj vihen në dispozicion të Qendrës.

Punonjësit efektivë të asaj zyre vazhdojnë ose i ndërpresin marrëdhëniet me institucionin përkatës sipas rregullave në fuqi.

Mjediset dhe pajisjet mbeten në dispozicion të organit nga varet kjo zyrë.

Neni 28

Deri në krijimin e mjediseve të veçanta, Qendra do të funksionojë në mjediset e vëna në dispozicion për këtë qëllim nga Ministria e Drejtësisë.

Neni 29

Dispozitat ligjore që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi më 1 dhjetor 1999.

**Shpallur me dekreten nr.2408, datë 14.7.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

**NDRYSHUAR ME
L I G J
Nr.9091, datë 26.6.2003**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8502, DATË 30.6.1999 "PËR
KRIJIMIN E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE"**

Në mbështetje të neneve 78 pika 1, 83 pika 1 dhe 117 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8502, datë 30.6.1999 "Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare", bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen këto ndryshime:

Fjalja e fundit në paragrafin e parë ndryshohet si më poshtë:

"Qendra e Publikimeve Zyrtare është institucion qendror, në varësi të Ministrit të Drejtësisë."

Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

"Qendra, me anë të botimeve, publikimeve dhe veprimtarive të tjera synon njohjen nga organet shtetërore dhe institucionet e tjera të administratës publike, nga personat fizikë dhe juridikë, të ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara ose në të cilat aderohet, akteve normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore, të akteve të tjera të rëndësishme të nxjerra nga organet dhe institucionet shtetërore, si dhe të teksteve e të literaturës juridike, në shërbim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të tyre, të forcimit të rendit juridik dhe kushtetues."

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 2

Qendra boton:

a) marrëveshje ndërkombëtare, të ratifikuara ose në të cilat aderohet, ligje, dekrete të Presidentit të Republikës, akte normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore, vendime të Gjykatës Kushtetuese së bashku me mendimin e pakicës, vendime të Gjykatës së Lartë për njësimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore, si dhe çdo akt e dokument tjetër të organeve shtetërore, botimi i të cilave është i detyruar me ligj;

b) akte të tjera nënligjore, që nuk përfshihen në shkronjën "a" të këtij neni;

c) raporte zyrtare ose dokumente të tjera të organeve dhe institucioneve shtetërore, përmbajtja e të cilave paraqet interes shtetëror dhe publik;

ç) revistën periodike "Drejtësia";

d) tekste juridike universitare, periodike, të organeve dhe institucioneve qendrore në

fushën e së drejtës dhe të literaturës juridike;

dh) indekse të përgjithshme dhe indekse për fusha të veçanta në ndihmë të subjekteve të interesuara dhe të publikut."

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 6

Botimi i akteve normative dhe i akteve të tjera nënligjore realizohet nga kjo qendër me botimin e Fletores Zyrtare, të përmbledhësve ose në forma të tjera, sipas fushave të legjislacionit.

Organi përgjegjës, sipas ligjit, është i detyruar të paraqesë për botim në Qendrën e Publikimeve Zyrtare aktet e parashikuara në shkronjën "a" të nenit 2 të këtij ligji brenda 3 ditëve nga miratimi i tyre dhe, në raste të veçanta, jo më vonë se 15 ditë.

Qendra duhet të realizojë botimin në Fletoren Zyrtare të akteve të parashikuara në shkronjën "a" të nenit 2 të këtij ligji brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tyre për botim nga organi përgjegjës sipas ligjit.

Botimi në Fletoren Zyrtare i akteve të parashikuara në shkronjën "b" të nenit 2 të këtij ligji realizohet, si rregull, brenda afateve të parashikuara në paragrafin e mësipërm.

Neni 4

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 7

Fletorja Zyrtare botohet rregullisht dy herë në muaj, në çdo 15 ditë, por jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja për botim e akteve të parashikuara në shkronjën "a" të nenit 2 të këtij ligji.

Në ndryshim nga rregulli i parashikuar në paragrafin e mësipërm, Fletorja Zyrtare botohet më shpesh ose përpara afatit të programuar, pasi të jetë marrë miratimi i Ministrisë së Drejtësisë ose i Këshillit të Qendrës, mbështetur në kërkesën e organit përgjegjës, që ka nxjerrë aktin, ose në përmbajtjen e dispozitave të aktit të paraqitur për botim.

Fletorja Zyrtare përgatitet dhe kalon për botim me miratimin dhe nën përgjegjësinë e Drejtorit të Qendrës dhe, në mungesë të tij, nga i autorizuari prej tij.

Në Fletoren Zyrtare detyrimisht shënohet data e botimit të saj, në të kundërt publikimi nuk sjell pasojë juridike.

Këshilli i Qendrës miraton rastet dhe mënyrën e publikimit elektronik të përmbajtjes së Fletores Zyrtare. Këto publikime synojnë njohjen e të interesuarve me përmbajtjen e saj dhe nuk sjellin pasojë juridike.

Formati, kriteret teknike, procedurat e përgatitjes, autorizimi i botimit, tirazhi, mënyra e vënies në qarkullim dhe shpërndarja e Fletores Zyrtare, si dhe rregullat për përgatitjen, miratimin dhe publikimin e botimeve të tjera juridike të Qendrës, përcaktohen nga Ministri i Drejtësisë, pasi të ketë marrë mendimin e Këshillit të Qendrës.

Ribotimi dhe publikimi i plotë ose i pjesshëm i Fletores Zyrtare nga të tretë, me çfarëdo lloj mjete, është i ndaluar."

Neni 5

Paragrafi i tretë i nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

"Qendra, brenda 24 orëve nga data e botimit, dërgon Fletoren Zyrtare në organet

shtetërore, institucionet dhe subjektet për të cilat është e detyruar të realizojë shpërndarjen me mjetet e veta, si dhe e dorëzon Fletoren Zyrtare në shërbimin postar, të kontraktuar për shpërndarjen e saj subjekteve të tjera, sipas listave të hartuara nga Qendra e Publikimeve Zyrtare."

Neni 6

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 17

Të ardhurat nga shitja ose shërbimet derdhen:

90 për qind në Buxhetin e Shtetit;

b) 10 për qind në buxhetin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare, për përmirësimin e punës dhe për shpërblimin e punonjësve të saj.

Qendra, në përputhje me ligjin, ka të drejtë të përfitojë grante, sponsorizime dhe kontribute të tjera, nga subjekte vendase ose të huaja, të cilat përdoren për ushtrimin e veprimtarisë, sipas nenit 2 të këtij ligji."

Neni 7

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 19

Organi më i lartë vendimmarrës i Qendrës së Publikimeve Zyrtare është Këshilli i saj.

Këshilli drejtohet nga përfaqësuesi i caktuar nga Ministri i Drejtësisë dhe ka në përbërje juristë, që përfaqësojnë Presidencën, Kuvendin, Këshillin e Ministrave, Gjykatën Kushtetuese, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Gjykatën e Lartë, Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës."

Neni 8

Në nenin 21 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) shqyrtimi dhe propozimi për miratim i drejtimeve të përgjithshme dhe i programit vjetor të veprimtarisë së Qendrës, si dhe ndjekja dhe kontrolli i zbatimit të tyre;"

Në shkronjën "b", fjalët "shkronjën "b"" zëvendësohen me fjalët "shkronjën "d"".

Pas shkronjës "d" shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje:

"dh) miratimi i përbërjes së Këshillit Botues të Revistës "Drejtësia"."

Neni 9

Paragrafi i parë dhe i pestë i nenit 22 shfuqizohen.

Neni 10

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 24

Struktura, organika dhe pagat e punonjësve të Qendrës caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Drejtori i Qendrës gëzon statusin e nëpunësit civil.

Punonjësit e administratës së Qendrës së Publikimeve Zyrtare janë nëpunës civilë. Pranimi, transferimi, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë, u nënshtrohen kritereve dhe procedurave të parashikuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të personelit administrativo-teknik rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Rregullorja e brendshme e Qendrës miratohet nga Ministri i Drejtësisë, pasi të ketë marrë mendimin e Këshillit të Qendrës dhe të Drejtorit të saj.

Ministri i Drejtësisë miraton dhe kontrollon zbatimin e drejtimeve të përgjithshme dhe programin vjetor të veprimtarisë së Qendrës, si dhe llogaritë financiare të saj, sipas dispozitave ligjore në fuqi.”.

Neni 11

Në të gjitha dispozitat e këtij ligji, fjala "Komision" zëvendësohet me fjalën "Këshill".

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3897, datë 17.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**